

PREFEKTURA DIBËR
Ardhur
Nr. 662 dt 23.07.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2778

Nr. _____ Prot

2307

Peshkopi, më _____.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 28

Datë: 22.07.2025 si dhe projekt-vendimin nr.01 Datë 14.07.2025

**“PËR NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR,
BASHKIA DIBËR”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi



100 pie



2778/30/07/25
PESHKOPI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr 662/1 Prot.

Peshkopi, më 29/07/2025.

Lënda: Për Vendimin nr 28, datë 22.07.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Dibër - PESHKOPI-

Në mbështetje të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", (i ndryshuar), neni 15 "Marrëdhëniet e prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore", neni 16, "Verifikim i ligjshmërisë së akteve", verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër, nr. 28, datë 22.07.2025, "Për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendorë me procedurë të përshpejtuar, Bashkia Dibër" protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 662 prot, datë, 23.07.2025, vendosa:

Të miratojë në parim vendimmarrjen e lartëcituar në kushtet e respektimit rigoroz të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në atë fushë të së drejtës në përgjithësi, të Ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", (i ndryshuar), si dhe VKM Nr.686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit"(e ndryshuar) në veçanti, që kurdoherë është përgjegjësi administrative-ligjore e strukturave përgjegjëse të bashkisë që paraqesin projekt akte të kësaj natyre.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM

Nr. 28 Datë 22 / 07 /2025

**“PËR NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR,
BASHKIA DIBËR”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në nenin 13, pika 1, shkronja “b”, në nenin 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në nenin 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, e ndryshuar, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **22.07.2025** me 16 vota pro 0 kundër 0 apstenim :

VENDOSI:

1. Të ndërmarret nisma për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të përshpejtuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
 - a. Duhet të marrin konfirmimin e institucioneve të fushës për garantimin e ruajtjes së vlerave natyrore e mjedisore, të trashëgimisë historike e kulturore dhe çështjeve të tjera sektoriale;
 - b. Integrojnë vendimet e KKTU-së;
 - c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mosperputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor;
 - d. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale;
 - e. Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është dokumenti i nismës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Diber.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Diber.
5. Vendimi u shpall më datë **22.07.2025**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irini SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

P/VENDIM

Nr 01, Datë 14.07.2025

**“PËR NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR,
BASHKIA DIBËR”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në nenin 13, pika 1, shkronja “b”, në nenin 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në nenin 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, e ndryshuar, Kryetari i Bashkisë,

KERKOJME:

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të përshpejtuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
 - a. Duhet të marrin konfirmimin e institucioneve të fushës për garantimin e ruajtjes së vlerave natyrore e mjedisore, të trashëgimisë historike e kulturore dhe çështjeve të tjera sektoriale;
 - b. Integrojnë vendimet e KKTU-së;
 - c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mosperputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor;
 - d. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale;
 - e. Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian
2. Pjesë integrale e këtij p/vendimi është dokumenti i nismës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Dibër.
4. Vendimi për miratimin e Nismës dhe dokumenti i Nismës botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.

Drejtori Dpzht
Blerina Mazari

Pergj/Dpzht
Elvis Manga

Pergj/Dpzht
Edvin Shani

Specialist/Dpzht
Fabion Zerja

Drejtor/Juridik
Ismet Saraci

Zv/Kryetar
Lorenc Cibaku






BASHKIA DIBER

NISMA

PËR RISHIKIMIN E
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA DIBER

KRYETARI

RAHIM SPAHIU



neg/026 data 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
BAZA LIGJORE	4
1. Qëllimi dhe nevoja për rishikim të dokumentit të planifikimit.....	5
2. Dokumentet, pjesë e PPV, të cilat do të nënshtrohen rishikimit	8
3. Ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës që do të rishikojnë PPV-në	9
4. Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike	9
5. Plani i veprimit për rishikimin e dokumentit të planifikimit.....	9
6. Pezullimi i zhvillimeve në territorin administrativ të bashkisë	10

HYRJE

Bashkia Diber ndodhet në Shqipërinë Verilindore. Ajo përbehet nga 15 njësi administrative. Bashkia ka një sipërfaqe prej 937.88 km² dhe një popullsi prej 778,940 banorë.

Karakteristikat gjeografike/territoriale

Rrethi i Dibrës bën pjesë në rajonin veri-lindor me një reliev përgjithësisht kodrinor-malor. Pra shtrihet në Veri-lindje të Shqipërisë në dy anët e luginës së Drinit të Zi duke u kufizuar në lindje nga varg mali i Korabit dhe në perëndim nga vargmalet e Lurës. Qendra e rrethit është qyteti i Peshkopisë. Qendra e rrethit (Peshkopia) shtrihet 95 km nga kryeqyteti me perfundimin e rrugës së Arbrit dhe 19 km largësi nga pika e doganës së Bllatës në Maqellarë. Ky rreth është vendosur në këto koordinata gjeografike: 41° 53' 20", dhe 41° 33' 40" gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 34' 50" dhe 20° 07' 00" gjatësi gjeografike lindore. Kufizohet nga kufij konvencionalë në lindje me republikën e Kosovës dhe të Maqedonisë me një gjatësi kufitare 90 km nga të cilat 19 km janë lumorë. Në veri kufizohet me rrethin e Kukësit me 75 km vijë kufitare. Në perëndim me Mirditën 13 km vijë kufitare dhe me rrethin e Matit me 60 km vijë kufitare. Në jug me Bulqizën 27.8 km vijë kufitare.

Ky rreth ka një ndërtim të komplikuar gjeologjik që është kapur herë pas herë nga lëvizjet neotektonikë gritës që ka luajtur një rëndësi të mëdha në formimin e relievit. Rrethi i Dibrës ka një reliev kodrinor-malor që varion nga 350 m (luginë e Drinit të Zi) deri në 2751 m në majën e Korabit. Bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe mesdhetare para malore meqenëse është pjesë përbërëse e pellgut të Drinit të Zi. Ka një hidrografi të pasur me burime mbi tokësore dhe nëntokësore ku dega kryesore është Drini i Zi. Dibra dallohet për shumëllojshmërinë e tokave të cilat për shkak të relievit malor shprehen qartë. Gjejmë brezin e tokave aluvionale rreth lumit të Drinit të Zi, të kafenjta, të murrme pyjore dhe atë livadhore malore. Në këtë takojmë breza bimorësi: brezi i dushqevc, ahut dhe haloreve dhe kullotave alpine. Ky rreth ka një popullsi prej 75000 banorë është vendosur në 1088 km kryesisht në vendbanime të rralla e rurale. Nga pikëpamja administrative ky rreth ka në përbërjen e tij 1 bashki (bashkinë e Peshkopisë) dhe 14 njësi administrative.

Pozita e këtij rrethi ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj zone që ka qenë herë pozitiv e herë negativ gjatë periudhave të ndryshme historike dhe në ndikimin e faktorëve socialë dhe ekonomikë që kanë lënë gjurmë. Rolin e saj pozitiv ajo e ka patur kur ka shërbyer si një urë lidhëse për trevat e vendit tone nga perëndimi në brendësi të territore veshqiptare. Qënëantikut ka funksionuar rruga DURRËS-FUSHA e TIRANËS-DIBËR e cila lidhte bregdetin me vise të tjera lindore. Rolin e kësaj pozite e dëshmon qarte zhvillimi social-ekonomik, pasinë 1911 Dibra ishte një qendër e rëndësishme artizanale, tregtare, ndërtimore etj; për këtë flasin qartë të dhënat e popullsisë kur ky rreth kishte 11000 banorë

BAZA LIGJORE

Bashkia Diber kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit për një pjesë të territorit me procedurë të përshpejtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

- Neni 26, pika 2 e Ligjit Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcakton:

"Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit European".

- Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, përcakton:

Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave.

procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet:

a) kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit, për çështje të zhvillimit, të cilat duhet të marrin konfirmimin e institucioneve të fushës për garantimin eruatjes së vlerave natyrore e mjedisore, të trashëgimisë historike e kulturore dhe çështjeve të tjera sektoriale;

b) për integrimin e vendimeve të KKTU-së.

Referuar nenit 12, pika 1 të VKM Nr. 686/2017, e ndryshuar, Dokumenti i nismës për hartimin e PPV-së, përmban: a) hartimin e dokumentit të Nismës për rishikimin e pjesshëm të dokumentit përkatës të planifikimit, duke specifikuar:

i. qëllimin dhe nevojën e rishikimit të planit;

ii. dokumentet apo pjesët përbërëse të tyre, subjekt rishikimi;

iii. ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit;

iv. përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike duke specifikuar afatet;

v. planin e veprimeve për rishikimin e dokumentit;

vi. sipas rastit, vendimin për pezullimin e zhvillimit për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi, sipas nenit 33 të Ligjit, shoqëruar me hartën përkatëse.

b) këshillimin e projektdokumentit të nismës me Agjencinë dhe publikun nëpërmjet Regjistrisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit;

c) botimin e dokumentit përfundimtar të nismës, me reflektimet përkatëse në rast të komenteve, shoqëruar me vendimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit për ndërmarrjen e nismës.

Procesi i rishikimit të PPV-sëdo të bazohet në Ligjin Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, Udhëzimin Nr.1 datë 22.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", i ndryshuar si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Po sipas përcaktimeve ligjore, autoriteti përgjegjës për rishikimin e PPV-së është kryetari i Bashkisë. Dokumenti do të hartohet në bashkërendim dhe këshillim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

1. Qëllimi dhe nevoja për rishikim të dokumentit të planifikimit

Me Vendimin Nr.2, datë 14.04.2017, Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Diber. Gjatë periudhës së zbatimit të tij, bashkia ka evidentuar disa vështirësi në zbatimin e këtij dokumenti të listuara si më poshtë:

1. Burimet e kufizuara financiare
Bashkia ka mungesë fondesh të mjaftueshme për të realizuar projektet e prioritetit të lartë të parashikuara në PPV. Investimet për infrastrukturë, shërbim baze dhe zhvillim rural varen me shumë nga fonde qendrore dhe donatore
2. Ndertime informale dhe pa leje
Në shumë zona vecanerisht në periferi të Peshkopisë në fshatra dhe në zona të thella malore vijojnë ndertimet pa leje me shkelje të kushteve të urbanistikës. Këto ndertime shpesh nuk respektojnë kufizimet e PPV-së për distancat, përdorimin e tokës, zonat e mbrojtura, infrastrukturën.
3. Mungesa e kontrollit të territorit
Për shkak të terrenit të vështirë, mungesës së stafit teknik dhe burimeve, bashkia ka vështirësi në monitorimin dhe inspektimin sistematik të ndertimeve, vecanerisht në zonat e largëta. Kjo krijon një boshllëk midis planifikimit dhe realitetit në terren.
4. Zvaritje dhe paqartësi në legalizime
Shumë ndertime të vjetra sidomos në fshatra janë ende të paligjshme dhe pa status pronësie të qartë. Kjo pengon zbatimin e projekteve të planifikuara në këto zona sipas PPV-së si dhe nuk lejon ndërhyrje publike (rruge, kanalizime etj)
5. Konfliktet në zonat me status të vecantë
Në disa raste ka ndertime në proces ose të reja që ndodhen brenda kufijve të zonave të mbrojtura mjedisore ose në zona me rrethik (rreshqitje, permbytje)
6. Shkelje të distenacioneve të përdorimit të tokës

Ndertime banimi ose komerciale janë ngritur në zona bujqësore, toka pyjore apo në korridore infrastrukturore të planifikuara. Kjo vjen si pasojë e mosperputhjes mes planeve urbanistike dhe lejeve të dhëna në të kaluarën ose jashtë sistemit ligjor.

7. Përdorimi i kufizuar i teknologjise dhe sistemit GIS

Bashkia ende nuk ka një sistem të integruar monitorimi të ndërtimit në kohë reale (p.sh. Përmes GIS-it) Çka e vështirëson ndjeshëm kontrollin dhe analizën krahasuese me PPV-në.

Permbledhje e nevojave dhe sfidave të evidentuara në territor, sipas tipologjise së rasteve.

Në procesin e analizës dhe monitorimit të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Diber, janë evidentuar një sërë nevojash dhe problematika që vijnë nga situata të perseritura në territor, të cilat mund të grupohen sipas katër tipologjive kryesore:

Zhvillimi i pakontrolluar ndërtimor në zonat rurale- Janë evidentuar ndertime jashtë zonave të përcaktuara për zhvillim, shpesh në mungesë të infrastrukturës mbështetëse dhe pa respektuar kushtet teknike të lejuara.

Mungesë harmonizimi midis kufijve kadastrale dhe kufijve të njësive të planifikimit- Në disa zona janë vërejtur mosperputhje që krijojnë paqartësi në aplikimin e kufizimeve përdorimit të tokës dhe krijojnë vështirësi për pajisjen me leje ndërtimi.

Kërkesë e shtuar për legalizime jashtë parashikimeve të PPV-së – Numri i lartë të aplikimeve për legalizim në zonat me përdorim të ndaluar apo të përcaktuar në plan evidenton nevojën për rishikim të kufijve të zhvillimit të lejuar dhe për një reflektim me të saktë të realitetit në terren.

Zhvillim ekonomik i ngadalte dhe mungesë zonash të përcaktuara për industri dhe agroperpunim- Nevoja për destinacione të reja ekonomike është theksuar nga kërkesat për zhvillim privat që nuk gjejnë korrespondencë në zonifikimin ekzistues.

Vështirësi në akses dhe shërbimeve për disa zona të thella rurale- Në mungesë të infrastrukturës rrugore ose shërbimeve bazë, janë identifikuar problematika të shpërndarjes së drejtë të zhvillimit dhe shërbimeve, që ndikojnë në zbasjen e katër zonave.

Kufizime mjedisore dhe peisazhore që nuk janë të pasqyruara qartë në dokumentacionin grafik- Janë evidentuar pasaktësi në përfshirjen e zonave të mbrojtura natyrore ose me vlera të vecanta peisazhore, duke sjellë paqartësi për zhvillimet që mund të lejohen në këto zona.

Nevoja për rishikim të instrumenteve të detajuar të planit- Janë vërejtur raste të perseritura ku mungesa e planeve të detajuar ose rregulloreve të zbatimit ka sjellë vështirësi në zbatimin e PPV-së në praktikë.

Arsyet për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Planit, lidhen kryesisht me nevojën e bashkisë për:

Reflektimin e realitetit të ri zhvillimor, sfidat territoriale, dhe prioritetet strategjike që nuk janë përmbushur plotësisht nga plani ekzistues.

- 1- Zhvillimi i banesave, migrimi i brendshëm, investimet e reja dhe ndërtimet në përdorimin e tokës kërkojnë një plan të përditësuar që të reflektojë realitetin në terren. PPV ekzistuese është tejkaluar në disa drejtime dhe nuk përfshin të gjithë zhvillimet e ndodhura pas vitit 2017.
- 2- Adresimin e vështirësive në zbatimin e planit ekzistues
Zbatimi i PPV-se ka hasur probleme të shumta praktike, ndetime informale, mungesë kontrolli, mungesë kapacitetesh dhe financimi. Kjo kërkon një rishikim të planit për ta bërë atë më të zbatueshëm dhe të lidhur me kapacitetet reale të bashkisë.
- 3- Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shfrytëzimin e potencialeve natyrore
Dibra ka një potencial të madh në bujqësi, turizëm malor, agro turizëm dhe energji alternative që nuk janë reflektuar mjaftueshëm në PPV-në aktuale.
Bashkia ka nevojë për një plan që orientohet drejt zhvillimit rural të qëndrueshëm dhe ruajtjes së burimeve natyrore.
- 4- Integrimin dhe balancimin e zhvillimit mes qendrave urbane dhe zonave rurale
Nevoja për të mos lënë pas dore qendrat e largëta malore, të cilat shpesh kanë mbetur jashtë vëmendjes së investimeve dhe planifikimit. Rishikimi synon të balancojë zhvillimin territorial dhe të mos përqendrohet vetëm në qytetin e Peshkopisë.
- 5- Permisimin e infrastruktures dhe ofrimit të shërbimeve publike
Bashkia ka nevojë për një orientim të qartë të investimeve në rrugë, ujësjellës, kanalizime. Rishikimi i PPV-se do të aksesojë aksesin në fondet publike dhe donatore duke pasur një dokument me funksional dhe të përqendruar në nevojat konkrete.
- 6- Harmonizimin me strategjitë dhe politikat kombëtare
Nevoja për përputhje me dokumentat si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim etj

Mbështetur dhe në rezultatet e analizave të mësipërme, PPV e rishikuar do të zgjidhë problematikat që lidhen edhe me menaxhimin e territorit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bashkisë.

- 1- Informaliteti dhe ndërtimet pa leje
Permisimi i mekanizmave për kontrollin dhe parandalimin e ndërtimeve informale. Saktësimi i zonave ku lejohet ndërtimi dhe përcaktimi i qartë i kufizimeve për të parandaluar ndërhyrje të paligjshme
- 2- Mungesa e harmonizimit me realitetin aktual

Perdisimi i PPV-se sipas zhvillimeve te fundit urbane, infrastrukturore dhe demografike. Rregullimi i gabimeve apo kontraditave te planit ekzistues qe kane penguar zbatimin e duhur.

3- Zhvillimi i qendrueshem i territorit

Percaktimi me i qarte i zonave te mbrojtura, te rrezikuara nga fatkeqesite natyrore (rreshqitje, permbytje) Intefrimi i masave per mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore.

4- Permisimi i infrastruktures

Parashikimi i investimeve per rruge, ujesjellesa, kanalizime dhe energji ne perputhje me nevojat reale te komunitetit. Perfshirja e zonave malore dhe te largeta qe kane qene me pak te perfshira me pare.

5- Perfshirja me e madhe e komunitetit dhe institucioneve

Rritja e transparences dhe pjesmarrjes se banoreve ne procesin e planifikimit. Bashkimi me i mire ndermjet bashkise, institucioneve qendrore dhe paleve te interesuara.

6- Zgjidhje e problemit me pronesine dhe legalizimit

Permisimi i identifikimit te prones dhe zgjidhja e konflikteve per tokat dhe ndertesat. Mbeshtje me e madhe per procesin e legalizimit ne lidhje me planin.

Stafii Drejtorise se Planifikimit te Territorit pranë bashkise Diber kaanalizuar me vemendje planin dhe ka njoftuar kryetarin e Bashkise per cështjet e evidentuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilat nevojitet të rishikohen dhe i ka propozuar për rishikimin e këtij plani, me qëllim te pershtase zhvillimin teritorial te bashkise me realitetin aktual, nevoja komunitare, burimet ekonomike dhe sfidat mjedisore duke garantuar zhvillim te qendrushem dhe te balancuar per te gjithë territorin.

2. Dokumentet, pjesë e PPV, të cilat do të rishikohen

Bazuar në analizën e dokumentit të planifikimit në fuqi si dhe bazuar në sa më sipër, është evidentuar që dokumentat që do të preken nga procesi i rishikimit të PPV, janë:

1- Dokumentet e brendshme te bashkise

2- Dokumentet kombetare dhe ndersektoriale (qe duhet te meren parasysh per perpuethshmeri)

Përmbajta e dokumentit të rishikuar të PPV do të bazohet në nënin 57 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", dhe udhëzimeve të nxjerra nga AKPT, konkretisht do të përmbajë:

- Dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, ku jepen:

a) ndërhyrjet në nenet e Rregullores vendore të Planit;

b) ndërhyrje në pasaportat e njësive strukturore;

c) etj, sipas analizimit të detajuar që po i bëhet planit të përgjithshëm vendor.

- Relacioni argumentues i ndryshimeve me ilustrimet përkatëse.

3. Ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës që do të rishikojnë PPV-në

Përsa i përket organizimit të strukturave të përfshira në procesin e rishikimit të PPV-së, dokument i rishikimit të PPV do të hartohet nga stafi i Bashkisë në bashkërendim dhe bashkëpunim me stafin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Stafi i bashkisë, i cili do të angazhohet në rishikimin e dokumentit të PPV, listohet si më poshtë:

Elvis Manga	<u>(ekspert planifikimi)</u>
Fabion Zerja	<u>(ekspert GIS)</u>
Blerina Mazari	<u>(ekspert mjedisor)</u>
Ismet Saraci	<u>(ekspert jurist)</u>

Grupi i punës do të marrë në konsiderat kërkesat e ardhura në adresë të Bashkisë, të cilat lidhen me zbatimin e PPV-se, do të shqyrtojnë dhe do të propozojë rishikimin emospërputhjeve midis pjesëve të ndryshme të PPV-së si dhe do të përgatisë relacionet përkatëse.

4. Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike

Gjatë hartimit të dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është tepër e rëndësishme të sigurohet një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet autoriteteve qeverisëse dhe komunitetit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme vendore, të hasura gjatë periudhës së zbatimit të PPV-së.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr. 686/2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, bashkërendimi dhe këshillimi i PPV-së është përgjegjësi e njësisë së qeverisjes vendore dhe parashikohet të kryhet një takim publik me grupet e interesit.

Grupi i punës do të analizojë dhe rishikojë çdo kërkesë të ardhur pranë Bashkisë Diber.

Komentet dhe propozimet e takimeve publike do të reflektohen dhe do t'i bashkëlidhen dokumentit të planifikimit.

5. Plani i veprimit për rishikimin e dokumentit të planifikimit

Pas ndërmarrjes së nismës për rishikimin e PPV-së do të bëhet njoftimi i palëve të interesuara dhe dokumenti i Nismës do të botohet në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

Hapat më kryesorë janë si më poshtë:

- a. Bashkia Diber do të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, përpara fillimit dhe gjatë procesit dhe gjatë rishikimit të PPV-së.
- b. Bashkia Diber këshillohet me AKPT-në dhe palët e interesuara. Bashkia i vë në dijeni rregullisht të interesuarit për ecurinë e procesit, nëpërmjet botimeve në regjistër;
- c. Vendimi i kryetarit të bashkisë, përgjegjës për marrjen e nismës, botohet në RKPT, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së nismës, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.
- d. Vendimi i kryetarit për marrjen e nismës bëhet publike edhe në faqen zyrtare të bashkisë.
- e. Bashkërendimi dhe këshillimi kryhet përmes botimit të dokumentit në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe, në rast se kërkohet, përmes organizimit të takimeve publike me ta.

6. Pezullimi i zhvillimeve në territorin administrativ të Bashkisë Diber

Referuar nenit 33 të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, bashkisë i rezervohet e drejta, që sipas rastit, me vendim të Kryetarit të Bashkisë të pezullojë zhvillimet për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi.

Konkretisht, gjatë procesit të rishikimit të dokumentit të planifikimit të territorit të saj administrativ, bashkia nuk propozohet të zbatohet instrumenti i pezullimit të zhvillimeve në territor.